



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 179/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterave në vende publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 5250 (pesëmijë e dyqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi)

### **Arsyetim**

Me datën 06.10.2013, subjekti politik PDK, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 06 Tetor 2013 n rrugën “Dëshmorët e Kombit”, subjekti politik LDK në Ferizaj ka vendosur posterin e kandidatit për kryetar të kësaj komune në shenjat e komunikacionit, me të cilin veprim sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje ligjore e Rregullave Zgjedhore si Kodit Etik i Subjekteve Politike si dhe Rregullën nr. 01/2012 për Kategorizimin e Gjorbave që parashihen me nenin 3 pika 2 e kësaj rregulle. Në cilësinë e provës, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik LDK, me datën 06.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 08.10.2013 deri në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LDK, lidhur me ankesën A.nr 179/2013, të paraqitur nga subjekti politik PDK, ku theksohet se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pabazuara sepse fotot e ofruara si provë nuk përmbajnë datë dhe se kandidatët e LDK e as Dega në Ferizaj nuk janë në dijeni për këtë poster dhe se lind dyshimi se posteri është i vendosur qëllimisht nga dikush tjetër që nuk i përket LDK-së

Andaj me këtë rast subjekti politik LDK kërkon nga PZAP-i që këtë ankesa ta hudhë si të pabazë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se si poster i kandidatit për kryetar komune të Ferizajt nga subjektit politik LDK është i vendosur në shenjat publike të komunikacionit, gjë që e bënë përgjegjëse subjektin politik LDK, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalon vendosjen e njoftimeve, pllakatave, posterave ose materialit tjetër i cili përdoret për fushatë zgjedhore në shenjat publike të trafikut.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Në përgjigje të ankesës nga subjekti politik LDK, përveç thënieve se nuk kanë njohuri se kush e ka vendos posterin në fjalë, dhe se kryetari i këtij subjekti politik dhe vet subjekti politik nuk kanë njohuri për rastin në fjalë subjekti politik LDK nuk kanë ofruar asnjë dëshmi që ka ndërmarr veprime serioze siç kërkohet me nenin 32.6 të LZP-së, për evitimin e shkeljes së supozuar.

Andaj duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i konstaton se subjekti politik LDK edhe më pare ka përsëritur shkeljen e natyres se njejte te shkeljes duke e thyer kodin e mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, shkelje për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë. Andaj në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it dhe nenit 120 paragrafi 1 pika (c) dhe 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

## Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja

A nr. 179/2013 më datën 09.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*